

REPUBLIC OF KOSOVO  
DOLUKA JE PRAVNI SUD  
GJYKATA THEMELORE E MITROVICË - OSNOVNI SUD  
MITROVICË - MITROVICA

25.05.2016  
[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD U MITROVICU - BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.113/2016

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga kolegji i gjyqtareve me kryetar gjyqtarin **Naim Mehulli** dhe porotë Enver Ramaxhiku dhe Enver Kunjiqi me procesmbajtësen Fetije Pireva në çështjen juridike të paditëses [ ] e vajzeris nga [ ] te cilën e përfaqëson Av. [ ] kundër te paditurit [ ] nga [ ] tani me vendbanim te pa njohur te cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Av. [ ] nga [ ], Anulim i Martesës, Gjykata me datën 13.04.2016 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **ANULOHET** Martesa ne mes te paditëses [ ] e vajzërisë nga [ ] e lindur me [ ] nga i ati [ ] e ëma [ ] dhe te paditurit [ ] nga [ ] tani me vendbanim te pa njohur i lindur i me [ ] , e lidhur ne zyrën e gjendjes civile me date 14.05.2012 me numër rendor [ ] dhe numër referencë [ ] ne bazë te padis, si rezultat i mungesës se qëllimit te bashkëjetesës se bashkëshorteve.
- II. Secila palë i barte shpenzimet e veta procedurale.


**A r s y e t i m**

Paditësja me datë 02.03.2016 ka parashtruar padi kundër te paditurës për anulim te martesës.

Gjykata me datë 13.04.2016 ka caktuar seance gjyqësore ne këtë çështje ku prezantuan i autorizuari i paditëses dhe përfaqësuesi i përkohshëm i palës se paditur.

I autorizuari i paditëses ne këtë seance deklaroi se mbetet ne tersi pran padis dhe kërkesëpadisë kërkoi nga gjykata qe te vazhdoi me procedimin e

mëtejme te kësaj çështje gjegjësisht me administrimin e provave dhe pas administrimit te provave ne mënyrë te pakontestueshme u vërtetua baza juridike e kërkesëpadisë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.



KA THEMELORE  
NOVNI SUB  
CE MITROVIC  
R PRIML

017 10 25

NË DORË  
ILJENR

qësuesi i përkohshëm i të paditurit ne shqyrtimin gjyqësor deklaroi se isht e kundërshtoi padinë, mirëpo pas administrimit te provave deklaroi se dministrimin e provave vërtetohet se paditësja me te paditurin ka r një marrëveshje e cila nuk ka quar ne bashkëjetesë te dy palëve për qellim pasur marrjen e një leje qëndrimi te paditëses ne RF andaj andaj kjo bazë i propozoi gjykatës duke e pasur parasysh dispozitat ligjore te ligjit familjen dhe interesat juridike te palëve qe kjo çështje te zgjidhet ne mënyrë rkuar me padi e cila është ne interes qe te dy palëve, shpenzimet e procedurës rkoji.

procedurën e provave gjykata administroi këto prova, certifikata martesore është 29.02.2016, dosja nr. Cs Js dt.20.08.2015, urdhri penal 20.08.2015, këshilla mbi te drejtën e ankesës dt.25.03.2014, urdhri penal ne hen fotokopjuar, shpallja ne gazetën epoka e re dt.23.03.2016.

ovrat e administruar gjykata i vlerësoi një nga një dhe te gjitha se bashku dhe a te njëjtat vërtetoi këto fakte:

ak është kontestuese fakti se palët ndrgjygjese kane lidhur martesë ne mes tyre e date 14.08.2012 këtë fakt gjykata e vërteton se baze te certifikatës se martesës, ndërsa nga kjo martesë nuk kanë fëmijë dhe nuk pritet te kenë.

o ashtu për gjykatën nuk është kontestueses se Gjykata Komunale ne ne urdhër penal nr. Cs Js dt.20.08.2015 e ka dënuar paditësen e shume prej 2700 euro, për shkak se paditësja me te paditurin kanë vepruar bashkërisht duke deklaruar se bashkëjetojnë edhe pse te njëjtit ne te vërtet nuk etojnë bashkërisht me qellim qe për vete apo për tjetrin te merr një titull qëndrimi ne RF Krejt kjo vërtetohet nga dosja nr. Cs Js dt.20.08.2015.


Nisur nga kjo gjendja gjykata aprovoi padinë e paditëses pas qe u vërtetua ne mënyrë te pa kontestueshme se martesë ishte e lidhur pa qellim bashkëjetesë, andej konform nenit 66 par 1 dhe 2 u vendos si ne dispozitiv te aktgjykimit.

Sa i përket shpenzimeve te procedurës gjykata vendimin e mori konform nenit 450 te4 LPK-ës, pasi i autorizuar i paditëses pas seancës kryesor ja ka paguar përfaqësuesit te përkohshëm shpenzimet e procedurës ku gjykatës ja ka bashkangjitur një kopje te pagesës.

Aktgjykimi bazohet ne nenin 143 par 1 e LPK.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,**  
**C. nr.113/2016 me dt. 13.04.2016**

**KRYETARI I KOLEGJIT-GJYQTARI**

**Naim Mehulli**  


**UDHËZIM UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankesë, brenda afatit 15 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtine. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate.

tes  
te  
si  
ce  
ie